



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
ASAMBLEJA

Nr. 179 prot.

Tiranë, më 24.02.2020

Vendim
Nr. 18 datë 21 shkurt 2020
Për miratim rregulloresh

Asambleja e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e saj të datës 21 shkurt 2020, në përmbushje të pikës 2 të rendit të ditës, njoftuar me vendimin nr. 10 datë 16.01.2020 të Kryesisë (bashkëngjitur), mori në shqyrtim:

1. Rregulloren e çmimeve shkencore që jepen nga Akademia e Shkencave (parashikuar në Statut për t'u miratuar nga Asambleja);
2. Rregulloren e veprimtarisë botuese (për miratim në parim);
3. Rregulloren e ceremonialit dhe të solemnitetit (rregullore e re, për miratim në parim).

Pas shpjegimeve që iu paraqitën Asamblesë nga akad. Skënder Gjinushi, Kryetar, lidhur me pajtueshmërinë e këtyre rregulloreve me Ligjin 53/2019; si dhe pas diskutimeve të anëtarëve të saj, u mor ky

Vendim:

1. Të miratohet në parim dhe në tërësi rregullorja "Për çmimet shkencore që akordohen nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë dhe për mënyrën e organizimit të konkurseve të tyre";
2. Të miratohet në parim rregullorja Për veprimtarinë botuese të Akademisë së Shkencave. Ngarkohet këshilli i botimeve si organ kompetent për miratimin përfundimtar të kësaj rregulloreje.

3. Të miratohet në parim rregullorja *Për ceremonialin dhe solemnitetin në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë*. Ngarkohet Kryesia për miratimin përfundimtar të saj si organ kompetent.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: Kryesia, sekretari shkencor, kryetarët e seksioneve dhe këshilli i botimeve.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

AKADEMIK SKËNDER GJINUSHI

